



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINË
GJP "GRADSKI JAVNI PREVOZNIK" A.D. PRISTINA
MPE "BUS STATION" J.S. PRISTINA

		NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. GJP "AUTOBUSKA STANICA" A. D. MPE "BUS STATION" J. S.	
Nr. No.	02/128	Data Date	14-01-2020
PRISHTINË/A			

Në pajtim me nenin 8 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, nenit 21, paragrafi 21.3, Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrje Publike (gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.31/20180), si dhe nenit 15.3 të Statutit të NPL "Stacioni I Autobusëve" Sh.A.Prishtinë, Bordi i Drejtorëve merr:

V E N D I M

- I. Anulohet konkursi për poziten zyrtar i Auditimit të brendshëm i ripublikuar me date:19.08.2019
- II. Bëhet rishpallja e konkursit për poziten Zyrtar/e Auditor i brendshëm
- III. Konkursi ripublikohet ne dy gazeta ditore dhe mbetet i hapur 15 ditë nga dita e rishpalljes.
- IV. Autorizohet departamenti juridik i ndërmarrjes që ti ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme dhe përgatitjet e duhura formale-juridike për publikimin e konkursit dhe pranimin e aplikacioneve për pozitat e lartcekura.

Arsyetim

Bordi i drejtorëve me dt.19.08.2019 ka ripublikuar konkursin për plotësimin e vendit të lirë të punës zyrtar/e i Auditor i brendshëm. Pas shqyrtimit të dokumentacioneve të aplikuesëve për pozitën Auditor të brendshëm të ndërmarrjes, dhe organizimit të testit me shkrim është proceduar me organizimin e intervistës me gojë. Gjatë mbajtjes së intervistes me gojë, kandidatët konkurent nuk kanë treguar rezultate dhe si rrjedhojë nuk kanë grumbulluar pikët e nevojshme për tu përzgjedhur. Në funksion të respektimit të kriterëve ligjore, gjatë procedurës së përzgjedhjes dhe rekrutimit të kandidateve për plotësimin e vendit të lire të punës, Bordi i Drejtorëve vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ti dërgohet:
1x1. Bordit të drejtorëve
1x1.Dep.juridik
1x1.Arkivit

Kryesues i Komisionit të Auditimit

Fatmir Miftari

